

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

E dëmtuara: përfaqësuesit ligjorë të të dëmtuarës [] Babai [] dhe nëna [], me vendbanim në lagjen [] lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës.

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën, PP.II.nr.8539/2013, të datës 11.10.2016 kundër të akuzuarit [] nga [] për shkak të veprës penale Trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.3 lidhur me 1 të KPRK-së.

Gjykata më 11.05.2017 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar, ndërsa shqyrtimi i dytë fillestar është mbajtur me dt:12.06.2017, duke vazhduar me shqyrtime Gjyqësore- të mbyllura për publikun nga dt:21.09.2017 e deri në dt:16.03.2018 kur edhe është bërë shpallja e aktgjykimit, në të cilat shqyrtime kanë prezantuar prokurorët e prokurorisë Themelore në Prishtinë-departamenti i përgjithshëm Naim Abazi, i akuzuari [] Av. I tw akuzuarit sipas autorizimit [] përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës [] babai [] dhe nëna []

Fjala Hyrëse.

Prokurori i shtetit *ne fjalën hyrëse ka deklaruar:* kjo aktakuzë është e mbështetur në ligj dhe prova të cilat i kemi propozuar të nxirren si provë historiat i pacientes që është trajtuar nga doktor [] në klinikën [] në spitalin [] historiat i pacientes që është trajtuar në klinikën [] në [] fotodokumentacioni, ekspertiza mjeko ligjor e dhënë nga eksperti gjerman dr. [] mendimi i komisionit të caktuar nga QKUK- klinika e ortopedisë ku theksojnë se nuk mund të japin mendim, mendimi i komisionit tre anëtarësh të përbërë nga dr. [], dr. [] dhe dr. [] ekspert mjeko-ligjor, dhe deklaratat e tyre ku të tre sqarojnë se mendimi i tyre ka konsistuar vetëm në anën procedurale se ka qenë trajtim në rregull por jo lidhur me përmbajtje, deklarata e përfaqësuesit ligjor të të dëmtuarës -dëshmitares []-babai [] dëshmitarët [] dhe [], i pandehuri [], dy Cd me rentegenin e [] datës 15.01.2013 dhe 20.09.2013 disa publikime lidhur efektin negativ të korsetit si dhe informacionet e siguruar gjatë procedurës paraprake.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës [] Babai [] në fjalën hyrëse ka deklaruar: pajtohem me fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit dhe nuk kam çka të shtoj.

Avokati Mbrojtës [] sipas autorizimit nga i akuzuari [], në fjalën hyrëse e ka deponuar me shkrim në kopje të mjaftueshme për palët, të njëjtën e ka elaboruar dhe gojarisht në seancën gjyqësore të datës 13.10.2017, dhe ndër të tjera ka theksuar se mbrojtja e të akuzuarit beson se pretendimet e paraqitura në këtë fjalë hyrëse, të cilat nuk janë vetëm këto, janë plotësisht të bazuara dhe se argumentimi I tyre në procesin vijues do të rezultojnë me aktgjykim lirues apo me tërheqje nga ndjekje penale nga ana e prokurorit të shtetit gjatë procesit gjyqësor. Lidhur me këtë fjalë hyrëse është deklaruar edhe i akuzuari [] I cili ka deklaruar se pajtohem me fjalën hyrëse të avokatit tim dhe nuk kam tjetër çka të shtoj. Fjala hyrëse e deponuar në formë të shkruar është bërë pjesë e procesverbalit të datës 13.10.2017 dhe e dosjes së lëndës.

Kompetenca e gjykatës.

Kompetenca territoriale - Gjyqtari ka vlerësuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 1 të KPPRK-së, ka kompetencë territoriale për ta gjykuar këtë çështje, për arsye se vepra penale është kryer në Prishtinë, që bie në kompetencë territoriale të kësaj Gjykate.

Kompetenca lëndore - Duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Gjykatat, Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore, është kompetentë për ta gjykuar një çështje, ku i pandehuri akuzohet për shkak të veprës Trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së. ku për këtë vepër penale parashihet dënim me burgim prej 1(një) deri në 8 (tetë) vite, dhe po ashtu kjo vepër penale nuk është përfshirë në nenin 22 të KPPRK-së.

Konstatimet e Gjykatës.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe të mbyllur për publikun, dëgjimit të dëshmitarëve dhe procedimit të provave personale e materiale, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: nuk është provuar se i akuzuari [] ka kryer veprën penale Trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën akuzohet.

Provat personale :

- Dëshmia e dëshmitarit []
- Dëshmia e dëshmitarit []
- Dëshmia e dëshmitarit []
- Dëshmia e dëshmitarit []
- Dëshmia e dëshmitarit dr. []

- Dëshmia e dëshmitarit dr.
- Dëshmia e dëshmitarit dr.

Provat materiale:

- Historiati i pacientes që është trajtuar nga dr. në klinikën dhe në spitalin, historiatit i pacientes që është trajtuar në klinikën në, fotodokumentacioni, ekspertiza mjekoligjore e dhënë nga eksperti gjerman dr. e dt. 07 Korrik 2016, mendimi i komisionit të caktuar nga QKUK-klinika e ortopedisë, mendimi i komisionit prej tre anëtarësh, dhe ekspert mjekoligjor, deklarata e përfaqësuesit ligjor të dëmtuarës-babai, deklarata e dëshmitarve dhe mbrojtja e të pandehurit Publikimet lidhur me afektet e korsetit, Sa i përket CD-ve prokurori ka deklaruar: meqenëse kanë qenë pjesë e ekspertizës nga eksperti gjerman, te njëjtat te mbesin prova ne shkresat e lendes por mund te mos shikohen,

Prokurori i shtetit dhe Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës janë deklaruar; pa vërejtje.

Ndërsa Av. për provat e lexuara është deklaruar; me vërejtje te pjesshme ne ekspertizën mjekoligjore dhënë nga eksperti gjerman dr. të cilën do ta elaboroj në fjalën përfundimtare.

Provat e shpallura te pa pranueshme,

Gjykata me aktvendimin procedural te dt:22.02.2018 deklaratat e dëshmitarëve :Dr.

Dr, dhe Dr, të dhëna në prokurori me dt:07.10.2016, janë shpallur prova të pa pranueshme dhe janë veçuar nga shkresat e lëndës pasi që të njëjtat janë marrë nga prokurori i shtetit në kundërshtim me nenin 130 par.1 të KPP-së.

Dëshmia e dëshmitarit/ve

Dëshmitari në shqyrtimin gjyqësorë të dt:13.10.2017 ndër të tjera ka deklaruar: mbetem në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici me dt:..3.12.2013 edhe pse ka kaluar kohë e gjatë, më kujtohet se vajza ime ka qenë me sëmundjen e Skoliozës të cilën e kemi trajtuar në institucionin “” dhe nuk me kujtohet emri i doktorit, ndërsa sa i përket dr.

kam dëgjuar nga familjaret se është mjek i mirë dhe vetëm njëherë e kam qenë të ky doktor vetëm në konsultë dhe kamë vërejtur një profesionalizëm te ai, ndërsa trajtimin e kemi vazhduar në spitalin e në Maqedoni, ndërsa ka shtuar se përgatitja e tije shkollore është Fakulteti Filozofik dhe se nuk jam kompetent të jap vlerësime dhe krahasime lidhur me trajtimet mjekësore.

Dëshmitari [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësorë të dt:02.11.2017 ndër të tjera ka deklaruar: se mbetem në tërësi pranë deklaratave të dhëna në Polici me dt:11.10.2013 dhe në prokurori me dt:14.09.2016, ku ka theksuar se vajzën e tyre [REDACTED] e kanë vizituar dhe është trajtuar nga tani i akuzuar Dr. [REDACTED] nga viti 2011 e deri në vizitën e fundit me 20.09.2013 fillimisht në spitalin [REDACTED] e më pastaj edhe në spitalin [REDACTED] ku ka qenë i punësuar i pandehuri, si dhe i janë përmbajtur të gjitha udhëzimeve të rekomanduara, si terapi fizikale dhe Not, ndërsa edhe përkundër këtyre gjendja shëndetësore e vajzës nuk është përmirësuar por vetëm është keqësuar, ashtu që nga shkalla e lakesës së shtyllës kurrizore që është konstatuar në fillim nga Dr. [REDACTED] nga 28 shkallë ka arritur në deri në 54 shkallë siç edhe është konstatuar në raportin e fundit mjekësor të dt:20.09.2013. duke shtuar se doktori gjatë periudhës së trajtimit mjekësor ka pas sjellje normale si me pacienten ashtu edhe me neve si prindër por që si mjek ka bërë matje të gabuara dhe ka rekomanduar terapi të gabuara ashtu që vajzës tonë i ka shkaktuar keqësim të shëndetit dhe jo përmirësim, pasi që shkalla e lakesës vetëm është rritur dhe nuk është ndal progresioni edhe përkundër terapive të marra sipas rekomandimeve të mjekut, duke shtuar se mendoj doktori [REDACTED] i ka shkaktuar dëme të mëdha shëndetit të vajzës tonë e edhe neve si prindër, ndërsa trajtimin me korsetë vajza e ka filluar sipas rekomandimeve të doktor [REDACTED] i cili i ka rekomanduar Korsetin e tipit Millwoke, ndërsa në pyetjet e avokatit mbrojtës dëshmitari është përgjigjur se ne kemi vepruar çdo herë sipas udhëzimeve të mjekut dhe nuk është e vërtetë se nuk e kemi vizituar vajzën çdo gjashtë muaj apo sipas nevojës por dy raporte nuk i kemi dhe se nuk e di a nuk i kemi marrë nga ordianca pas kontroleve apo i kemi humbur, ndërsa ka sqaruar se në raportin e dt:20.09.2013 doktor [REDACTED] e ka rekomanduar vendosjen e Korsetit- Ortozës TLSO, por pas kësaj kohe trajtimin e kemi vazhduar te konkretisht Doktor [REDACTED] i cili menjëherë ka rekomanduar vendosjen e Korsetit dhe prej 20.09.2013 i akuzuari fëmijën tim nuk e ka pa asnjëherë ndërsa për fund ka deklaruar se unë e kam parë një raport që i akuzuari e ka konstatuar që sëmundja është nga lindja ndërsa unë mendoj se është dashtë ta di se si quhet sëmundja që është nga lindja ndërsa kjo është në kundërshtim me raportet tjera të doktorëve tjerë që konstatojnë si sëmundje infantile, nëse nuk gaboj. Unë sa i përket dëshmisë time nuk kam tjetër çka të shtoj por lidhur me pyetjet te mia të cilat do t'ia bej të akuzuarit e rezervoj te drejtën ne vazhdim te procedurës.

Dëshmitari [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësorë të dt:02.11.2017 ndër të tjera ka deklaruar: se vajzën time me emrin [REDACTED] nga mosha [REDACTED] vjeçare. e kemi trajtuar edhe nga dr. [REDACTED] dhe është trajtuar shume mire nga doktori, zoti dhe doktori e unë e kam vajzën tani

mire, duke shtuar se sjellja e doktorit ka qenë korrekte dhe profesionale dhe po ashtu edhe ne ju kemi përmbajtur udhëzimeve të doktorit për çka edhe vajza tani është shumë mirë.

Dëshmitari në shqyrtimin gjyqësorë të dt:08.12.2017 ndër të tjera ka deklaruar: bazuar në dokumentacionin që tani më është prezantuar, ky rast nuk më kujtohet në detaje por nga këto raporte mund të konkludoj se në këtë rast janë përdorur metoda të përshtatshme për trajtimin e këtij deformiteti, ndërsa ka sqaruar se ka shkolla të ndryshme të rastet kur paraqiten me Skolioze ashtu që varësisht nga shkalla e deformitetit disa shkolla e trajtojnë me Korset ndërsa disa shkolla jo. Nga raportet që i pash sot nuk më kujtohet se i kam parë në atë kohë por meqenëse se unë sot i pash këtë dokumentacion konsideroj se gjithçka ka qenë në rregull dhe në momentin kur është arritur shkalla e deformitetit 48 shkallë, doktori e ka udhëzuar dhe ka shtuar se Ortoza sot nuk ndikon në përmirësimin por e ndal procesin e deformitetit mirëpo edhe kjo sot është e diskutueshme mes kirurgëve të cilët merren me këtë çështje, ndërsa sa i përket zhvillimit të skoliozës, korseti mundet me ndal por kjo nuk do të thotë që e shëron dhe nga kjo del se kjo nuk i dihet sepse varen edhe shumë faktor që në mjekësi nuk i dimë, ndërsa si sëmundje dihet që është gjenetike. duke sqaruar se sa i përket këtyre dy mjeteve (Ortozës TLSO dhe Miliwoki) që përdoren janë të përcaktuara nga shkolla të ndryshëm mjekësore të njëjtat kanë një qëllim ndaljen e progresit të deformitetit ndërsa nuk ka ndonjë rregull të veçantë se cila duhet të vendoset në rastin konkret. Në pyetjet e përfaqësuesit ligjor ka deklaruar se nuk më kujtohet se keni qenë në vizitë tek unë por në bazë të dokumentacionit me siguri keni qenë, ndërsa në bazë të raporteve pacientja ka qenë në 48 shkallë të deformitetit, duke shtuar se kjo sëmundje trajtohet edhe nga ortopedi dhe neurokirurgu në mënyrë Konservative, ndërsa në fund ka shtuar se të gjitha që I deklarova sot janë të dokumentuara në shkencën e mjekësisë dhe me tej mbetem pranë dëshmisë së dhënë sot dhe deklaramëve si më lartë.

Dëshmitari **Dr.** në shqyrtimin gjyqësorë të dt:25.01.2018 ndër të tjera ka deklaruar: më kujtohet rasti, janë në pyetje disa vjet, por si çdo pacient edhe ka ardhë pasi ja kam caktuar një termin, dhe është trajtuar në aspektin Ortopedik, si edhe është e konstatuar në raport mjekësor diagnoza e njëjta ka pasur Skolioz Ideopatique Torokale, që nënkupton një deformitet të boshtit kurrizor që paraqitet te fëmijët, ndërsa fjala ideopatique do të thotë e pa njohur, në raport e kam shënuar FTH,- Fizioterapi ndërsa ato tri pika çuditëse janë lëshim teknik. Në bazë të ekzaminimit kemi vlerësua se terapia duhet të jetë Millwoki, dhe sipas vlerave të një autor që quhet "Kobb" kemi shënuar lakese prej 54 shkallë, sipas historianit që unë posedoj deri me tani pacientja i ka ndërruar katër Ortoza, ndërsa lidhur me pyetjen e prokurorit se Ortoza

duhet të vendoset prej 20 deri në 50 shkallë, dëshmitari ka sqaruar se këtu kemi të bëjmë me mjekësi e jo me matematik çka do të thotë se një dhe një nuk bëjnë dy, prandaj edhe përcaktimi prej 20 deri në 50 shkallë është relativ dhe nuk është strikt, sepse janë edhe shume faktor tjerë të cilët duhet të analizohen për me mujt me prurje një vendim të plotë për trajtim, ndërsa në pyetje e përfaqësuesit ligjor dëshmitari ka deklaruar se trajtimi i skoliozës është trajtim dinamik dhe përherë duhet me u bë adaptime dhe eventualisht ndërime të Ortozës për shkak se fëmija është në rritje, krejt kjo me qëllim që të arrihet efektshmeria e trajtimit, ka shtuar se me rendësi është të këto raste të caktohet se çka është primare, ndërsa laka primare e krijon edhe një laka sekondare, gjerat tjera janë të lejuara por nuk janë absolutisht të domosdoshme të shënohen, fillimisht duhet të analizohen të gjitha kriteret e pastaj të vendoset forma e mjekimit pasi që në fillim e përmenda shprehjen ideopatikë që do të thotë e pa njohure që korrespondon me shkaqet e paraqitjes si dhe përcaktimin e prognozës së progresionit, dhe falë moshës së pacientit kemi pas mundësi me veprua dhe kemi arrite atë rezultat, ndërsa në pyetjen e gjykatës ka sqaruar se në botë ka disa shkolla të trajtimit të skoliozës, prandaj edhe fjala Millwoki vjen nga Amerika, shkollë e cila e ka zbuluar atë Ortozë. Në këtu mundohemi me respektua shkollën e Lionit e cila është e pranueshme në Botë, ndërsa ekzistojnë shkolla të cilat i japin prioritet fizioterapisë por ekzistojnë edhe shkolla që i japin prioritet Ortozave, e që kombinimi i këtyre dy shkollave është forma më e mirë, ndërsa Fizioterapia nuk ndikon në shëndetin e fëmijës sa për vendosjen e Ortozës duhet të analizohen të gjithë kriteret se a duhet vendos Ortozën a jo, duke pas parasysh edhe karakterin e fëmijës se a është bashkëpunues a jo e që në rastin e nuk është, sa i përket kësaj çështje nuk kam tjetër çka të shtoj.

Dëshmitari **Dr.** në shqyrtimin gjyqësorë të dt:22.02.2018 ndër të tjera ka deklaruar: në ekspertizën e dt:04.06.2014 dhe në deklaratën e dt:07.10.2016 është nënshkrimi im dhe nuk më kujtohet saktë, por kemi ardhë në prokurori me ftesë të Prokurorit Armend Hamiti dhe pyetja kryesore ka pas të bëjë me deklaratën plotësuese, nëse kemi pas në dispozicion grafitë të cilat janë realizuar gjatë kontrolleve të të dëmtuarës, ndërsa ka shtuar se kemi hyr bashkë unë, dhe ku kemi qëndruar së bashku edhe gjatë dhënies së deklaratës, në pyetjen e përfaqësuesit ligjor të të dëmtuarës ka deklaruar se në dhënien e mendimit profesional mjekoligjorë është përvjedhur një gabim teknik që ka mbetur nga forma e shabllonit dhe që ka të bëjë me ekzaminim fizik, nuk është bërë ekzaminimi fizik i pacientit, edhe pse në këto raste kërkohet edhe ekzaminimi fizik, por mendimi mund të jepet edhe nga dokumentacioni i ofruar, ndërsa më kujtohet se kur Prokurori ka kërkuar që të bëhet ekzaminimi Fizik e dëmtuara ka qene

jashtë vendit, dhe përfundimisht nuk është bërë ekzaminimi Fizik, ndërsa në pyetjet e gjykatës ka deklaruar se edhe më tej mbetemi pranë mendimit të dhënë në ekspertizën e dt:04.06.2014.

Dëshmitari **Dr.** [Emri i doktorit] në shqyrtimin gjyqësorë të dt:22.02.2018 ndër të tjera ka deklaruar: në ekspertizën e dt:04.06.2014 dhe në deklaratën e dt:07.10.2016 është nënshkrimi im dhe nuk më kujtohet saktë, por kemi ardhë në prokurori me ftesë të Prokurorit Armend Hamiti dhe pyetja kryesore ka pas të bëjë me deklaratën plotësuese, nëse kemi pas në dispozicion grafite të cilat janë realizuar gjatë kontrolleve të të dëmtuarës ndërsa ka shtuar se kemi hyr bashkë unë, dr. [Emri i doktorit] dhe dr. [Emri i doktorit], ku kemi qëndruar së bashku edhe gjatë dhënies së deklaratës, ndërsa në pyetjet e prokurorit të shtetit ka shtuar se mendimin e kemi dhënë në bazë të dokumentacionit mjekësor, në kuadër të të cilit ka qenë edhe një mendim profesional nga klinika e Ortopedisë nga Dr. [Emri i doktorit] dhe Dr. [Emri i doktorit] të cilët kanë paraqitur kriteret për mjekimin të deformitetit të boshtit kurrizor të fëmijët me Ortoza, kriteret e bazuara në protokolle të Sosortit si organizatë ndërkombëtare që përcakton trajtimin dhe rehabilitimin e skoliozave, ndërsa në kohën e zhvillimit të shkencës dhe të ortopedisë kur kemi të bëjmë me specializime të ngushta të segmenteve të veçanta të organizmit, nuk është obligim i secilit ortoped me u marrë me lëmin përkatëse, ndërsa në pyetjet e përfaqësuesit ligjore të të dëmtuarës ka deklaruar se nuk është bërë ekzaminimi fizik i të dëmtuarës, pasi që nuk është kërkuar që të bëhet nga ana e prokurorisë, duke shtuar se mendimin e kemi dhënë sipas kërkesës së prokurorisë që ka pas të bëjë me procedurat e trajtimit dhe jo me trajtimin e ngushtë të problemeve me të cilat merret Skoliologu dhe Ortopedi Spinal, ndërsa në pyetjen e gjykatës ka deklaruar se nuk e kemi pas në kuptimin fizik CD-radiografit dhe nuk e dimë përmbajtjen e sajë, ndërsa ka shtuar se edhe më tej mbetem pranë mendimit të dhënë në ekspertizën e dt:04.06.2014.

Deklarimi i të akuzuarit

I akuzuari [Emri i akuzuarit] në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt:22.02.2018 ndër të tjera ka deklaruar se: në fillim tek unë ka ardh një vajzë me nënën, vajza ka pas skoliozë dhe unë e kam përcjell disa vite gjatë kësaj kohe kam rekomanduar terapi fizikale sipas standardeve protokolleve të trajtimit të një problemi të tillë, në një moment gjatë vizitës të fundit të cilën e kam bërë unë e kam konstatuar se Skolioza është keqësuar, këndi është rritur gjithë që edhe mund të ndodh në procesin e sëmundjes sepse kur kemi të bëjmë me fëmijën në rritje dhe zhvillim dhe gjatë rritjes së fëmijët edhe Skolioza mund të përkeqësohet apo edhe të përmirësohet dhe për këtë nuk ka rregull të sakte se si sillen Skolioza gjatë rritjes, menjëherë kam reaguar dhe e kam rekomanduar Ortozën dhenë nga ajo vizite e fundit nuk e kam parë më as pacienten dhe nënën ndërsa babain me sa më kujtohet nuk e kam parë, mesa kuptova nga shkresat vajza e ka vendosur Ortozën si e dëgjuam

në seancën e kalume nga dëshmia e Dr. [REDACTED] gjendja e vajzës tani është mirë , nëse kjo që e kam vepruar konsiderohet trajtim i pandërgjegjshëm dhe të gjithë mjekët tjerë pas meje paskan bërë një trajtim të pandërgjegjshëm sepse edhe pas meje nuk ka ndërmarr asnjë veprim tjetër asnjë mjet tjetër dhe asnjë forme tjetër te trajtimit përveç atyre që i kam rekomanduar unë, të gjithë mjekët tjerë pas meje I kanë vazhduar, metoda të cilat unë kam rekomanduar i pari, ndërsa në pyetjen e prokurorit ka deklaruar se saktësisht nuk e di , vlerat e sakta nuk e di janë të shënuara në raportet të cilat i kam shënuar unë, por ka qenë vlera në suaza të kufijve të lakesës të cilët kërkojnë trajtim adekuat të cilin edhe e kam rekomanduar , sipas standardeve te lakesat 20-40 shkallë kërkohej terapi fizikale kurse mbi 40 shkalle kërkohej Ortozë, ndërsa sa i përket indikacioneve për operacion nuk është kriter vetëm lakesa ka shumë kritere te cilat duhet të merren parasysh, më kryesore është potenciali për progresion të skoliozës,po ashtu nuk është përcaktues kryesor vetëm shkalla e skoliozës për me vendos korsetin por janë edhe disa përcaktues tjerë, ndërsa nuk ka rregull te përcaktuar se ne çfarë shkalle duhet vendosur korseti, ndërsa lidhur me këtë ekzistojnë disa organizata te cilat i përcaktojnë standardet se kur duhet vendosur Korseti me shkallë të ndryshme, nuk është rregull përcaktues se ne momentin që pacientja arrin lakës 25 shkalle te vendoset Ortozë dhe për këtë arsyes ekziston kufiri 25-40 shkallë, nuk ka ndonjë rregull fikse për këtë, ndërsa sa i përket kësaj unë nuk e di se ne cilin protokoll janë e bazuar ndërsa sa i përket vendit ton Kosova nuk ka protokoll shtetëror për trajtimin e Skoliozës dhe vendosjen e Ortozës, prandaj ne duhet te adaptojmë protokollin e shteteve tjera, [REDACTED] është bazuar ne protokollin e Lionit, unë jam bazuar ne protokollin Amerikan ndërsa këta nuk e di se ku janë bazuar, sa i përket mendimit te mjekut gjerman ka theksuar unë nuk po e di dallimin se sa është mes mjekut gjerman dhe [REDACTED] sigurisht ka dallim aty, po ashtu ekzistojnë metoda të ndryshme te matjes, natyrisht vlerat duhet te jenë të përafërta por assesi identike, sepse ekzistojnë metoda të ndryshme te matjes si Cobb, ose metoda e Oxfordit, ka matje kompjuterike dhe ajo bëhet automatikisht këndi i skoliozës dhe më kujtohet se disa matje i kam bërë te [REDACTED], ka edhe matje laserike sipas metodave të Lionit duke shtuar se janë disa organizata të cilat merren me hulumtimin e Skoliozës dhe japin rekomandime për mënyrën e trajtimit te cilat varësisht nga studimet japin rekomandime te cilat me vite ndryshojnë, e si mënyra se si arrihet te shkalla sipas Cobb-it e sqarova me larte pra janë disa metoda për të cilat ne i përdorim për ta përcaktuar atë shkallë, dhe për me mbërri në shkallën 28 disa e përdorin kompjuterin disa ne mënyrë laserike disa metodat e Oxfordit, ekziston dhe është lejuar gabimet ne matje te quajtura si gabime njerëzore e të cilat nuk kanë në ndikimin e shëndetit te pacientes , diferencat e larta mund të ndikojnë por diferencat e ulëta nuk ndikojnë ne trajtim.

Në pyetjen e përfaqësuesve ligjorë të palës së dëmtuar se në bazë të dokumentacionit që ë ka marrë policia , pacienten me skolioz që keni trajtuar ju shihet që keni vendos Ortozë tek pacientet E.H 24 shkallë, B.P 10 shkallë, A.G 40 shkallë, a është dashtë të mbërri latesën në 54 shkallë për vendosjen e Ortozës, pse ky trajtim ndryshe? I akuzuari ka deklaruar se nuk është trajtim ndryshe i në polici i kam dorëzua krejt Pacientat që i kam e që Jane 153 emra te që i kam trajtuar , ka skoliozë Ideopatike me shkaktar të panjohur , nuk dihet pse është shkaktuar , ekzistojnë lloje të tjera të skoliozës , B.P me 10 shkallë ka pas skolioz kongjenitale që nënkupton keqformim të unazave me të lindur ndërsa këtu dihet progresioni dhe Vendoset Ortoza më herët, me krahasua me B.P, nuk munden me u krahasua sepse Janë dy raste të ndryshme, Ortoza nuk është e padëmshme, mundet me shkaktua dëme shumë te rënda , në aspektin teknik për mua ka qenë më së lehti të rekomandojë një Ortozë sepse unë vetëm e shënoj që të vendoset Ortoza, në rastin konkret te kemi të bëjmë me një fëmijë në rritje dhe Ortoza e vendosur herët mund te shkaktoj dëme të pariparueshme ne funksionin e zemrës, trurit dhe mushkërive, po ashtu në literaturë mund ti gjeni sqarime rreth tyre dhe për këtë arsye zhvillimi i shkencës rekomandon që përdorimi i Ortozës të zvogëlohet, ndërsa cila metodë ka pasoja me te mëdha përdorimi i Ortozës apo operacioni i njëjti ka deklaruar se varet prej suksesit të operacionit, nëse operacioni shkon pa komplikime do të thotë se eliminohet ky problem dhe shërohet , nëse ka komplikime atëherë ka pasoja, operacioni i skoliozës është me i vështiri, edhe sa i përket trajtimit me Ortozë komplikimet janë të mëdha ashtu që organet siç i ceka më lartë mund ti dëmtojë në mënyrë të pariparueshme, është një fakt që po e harrojmë se Ortoza nuk e shëron skoliozën, ndërsa efekti primar i saj është që të stopohet zhvillimi i skoliozës në shkallën të cilën gjendet edhe përkundër vendosjes së Ortozës, përqindja e rritjes se këndit me Ortozë është prej 20 deri 30 % edhe nëse vendoset Ortoza skolioza mund të rritet , ndërsa arsyeja pse nuk e kam rekomanduar Ortozën menjëherë është një prej efekteve negative të Ortozës (fenomeni i llastikut) ashtu që rekomandimi i bartjes dhe heqjes së Ortozës kërkon kohë në mënyrë që nëse hiqet menjëherë mund të shkaktojë pasoja me te mëdha pasi që latesa mund te rritet dhe te krijojë dëme të pariparueshme, ndërsa ka shtuar se për vendosjen e Ortozës nuk merret për bazë vetëm një kriter po edhe kriteret tjera si , niveli social, mosha biologjike, kockore, shkalla e Skoliozës niveli i rrezikut të veprimit të mjetit terapeutik,ndërsa ka shtuar se i kam propozuar Ortozën TLSO ndërsa në fotografi shihet se është vendosur një Ortozë e ngjashme e quajtur Millwoki qe e ka pjesën e qafës të shtuar ndërsa nëse e shihni nga ekspertiza e ekspertit gjerman kjo Ortozë nuk përdoret ne Gjermani, as unë nuk e përdori përveç ne rastet kur pacientet kanë deformimet ne pjesën e qafës ndërsa te deformimi nuk ka qenë ne pjesën e qafës por ne pjesën torakolumbale për çka edhe nuk e kam rekomanduar. Në pyetjet e gjykatë I njëjti është përgjigjur se nuk kemi ndonjë lidhje familjar dhe nuk I kam

njohtë me parë dhe , ndërsa gjatë trajtimit të me prindërit nuk kemi pasur ndonjë konflikt, ndërsa e kamë trajtuar me simpati pasi ka qenë afërsisht e moshës së vajzës time, sa herë që janë paraqit , jam sjell korrekt, ndërsa qëllimi I të gjitha veprimeve që I kam marrë në raport me ka qenë përmirësimi I gjendjes shëndetësore dhe as skam pas qëllim as arsye me dëmtua në aspektin shëndetësor, dhe nuk e konsideroj diçka normale me dëmtua dikë me qëllim, nuk kam tjetër çka të shtoj.

Fjala Përfundimtare e palëve.

Prokurori i shtetit fjalën përfundimtare e ka deponuar në form të shkruar, në kopje të mjaftueshme edhe për palët, e cila është bërë pjesë e dosjes së lëndës, ndërsa të njëjtën e ka elaboruar gojarisht në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt:13.03.2018 dhe ndër të tjera ka theksuar: Mbetëm në tërësi pran Aktakuzës së ngritur me datë 11.10.2016, kundër të akuzuarit për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Trajtim I Pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 219 par 4 lidhur me par 1 të KPK-së. Me datë 13.10.2017, Prokurori i Shtetit ka bërë ri cilësim, në atë mënyrë që konform nenit 3 të KPPK-së, e ka ri cilësuar Trajtim I Pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par 1 të KPRK-së. Mirëpo gjatë shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave materiale, dëgjimit të ekspertëve, dëgjimit të dëshmitarëve, përfaqësuesit ligjor të palës së dëmtuar dhe të akuzuarit bëjmë ri cilësimin duke mbetur edhe më tej pas kualifikimit veprës penale por duke shtuar paragrafin 3 të të njëjtës dispozitë, respektivisht veprës penale Trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par 3 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave materiale, dëgjimit të ekspertëve, dëgjimit të dëshmitarëve, përfaqësuesit ligjor të palës së dëmtuar dhe të akuzuarit u vërtetua se i akuzuar ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë Trajtim i Pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par 3 lidhur me par 1 të KPPRK-së sepse në periudhën Janar 2011 deri me 20.09.2013, i akuzuari në cilësinë e mjekitë me rastin e trajtimit të të dëmtuarës në spitalin “ .ka përdorur haptas një metodë të papërshtatshme të mjekimit ashtu që, nuk e ka paraqitur gjendjen reale të shkallës së deformitetit dhe nuk | ka rekomanduar me kohë mbajtjen apo përdorimin e ORTOZËS (korsetit) edhe pse në vazhdimësi në këtë periudhë kohore e dëmtuara ka qenë duke u trajtuar nga i akuzuari dhe si pasojë e kësaj ka ardhur deri te keqësimi i gjendjes shëndetësore të të dëmtuarës duke i shkaktuar devijim të rëndë të boshtit kurrizor, si dëmtim i rëndë trupor. Duke marrë për bazë të gjitha provat dhe dëshmitë e lartë cekura Prokuroria është e bindur se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe është përgjegjës për veprimet e tij, sepse duke përdorur metoda hapur të gabuar ka bërë matje të gabuara duke shkaktuar dëme të pariparueshme te e dëmtuara, vuajtje të rënda dhe të gjata jo vetëm të dëmtuarës por tërë familjes si dhe

shpenzime të mëdha financiare. Andaj duke marr për bazë të gjitha këto i propozojmë gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës- Babai [] fjalën përfundimtare e ka deponuar në formë të shkruar, në kopje të mjaftueshme edhe për palët e cila është bërë pjesë e dosjes së lëndës, ndërsa të njëjtën e ka elaboruar gojarisht në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt:13.03.2018 dhe nder te tjera ka theksuar- E përkrah fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit, gjithashtu parashtroj kërkesën pasurore juridike të cilën nuk e kemi precizuar ende.

Gjykata ne bazë të nenit 350 par .3 të KPP-së, pasi që prokurori i shtetit e ka bërë ricilsimin e veprës penale nga vepra penale Trajtim I Pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par 1 të KPRK-së. në veprën penale Trajtim I Pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, e ka njoftuar të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij se mund të kërkojnë kohë shtesë për përgatitjen mbrojtjes dhe paraqitjen e fjalës përfundimtare, ndërsa [] ka deklaruar se nuk kemi nevojë për kohë shtesë pasi që prokurori i shtetit në shqyrtimin paraprak e ka paparalajmëruar ri cilësimin juridik të veprës penale pikërisht në formën siç është bërë sot.

Avokati mbrojtës [] i të akuzuarit [] fjalën përfundimtare e ka deponuar në formë të shkruar, në kopje të mjaftueshme edhe për palët e cila është bërë pjesë e dosjes së lëndës, ndërsa të njëjtën e ka elaboruar gojarisht në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt:13.03.2018 dhe ndër të tjera ka theksuar: nga provat e propozuara nga prokuroria e shtetit të cilat janë administruar në shqyrtimet gjyqësore është vërtetuar gjendja faktike se i akuzuari e ka trajtuar të dëmtuarën me metoda botërisht të njohura dhe të aprovuara nga shkenca e mjekësisë, ndërsa nuk u propozua apo trajtua ndonjë provë materiale e cila do të dëshmonte të kundërtën, ndërsa sa i përket ekspertizës së dr. [] të dt 07..07.2016 ka shtuar se në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë tregon se mungon pasoja e dëmshme, duke vazhduar më tej lidhur me sqarimet se cilat elemente e plotësojnë figurën e veprës penale si përdorimin e metodës Haptas si dhe elementin e dashjes, elemente këto të cilat nuk janë konsumuar në rastin konkret, ndërsa sa i përket ri cilësimit të veprës penale ka deklaruar se si mund të shkaktohet dëmtimi i rëndë trupor i shëndetit kur dëmtimi është shkaktuar nga faktori gjenetik e jo nga veprimet e të pandehurit, ndërsa përfundimisht i ka propozuar gjykatës që në mbështetje të nenit 346 par.1 pika3 të KPP-së të marrë aktgjykim lirues, sepse nuk është provuar me asnjë provë se i akuzuari [] ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi dhe nuk kam tjetër për të shtuar.

Vlerësimi i provave,

Gjykata i ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale, trajtim i pa ndërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par 3 lidhur me par.1 të KPRK-së. ose ndonjë vepër tjetër e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, dhe se një gjendje e tillë faktike si në diapozitivin e këtij aktgjykimi është vërtetuar nga dëshmitë dhe provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore në këtë çështje penale.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese të të pandehurit në aktakuzë, nuk rezulton se në veprimet e tij qëndrojnë elementet e veprës penale nga neni 260 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së. Sipas përkufizimit ligjor të nenit 260 par.3 lidhur me 1 të KPRK-së vepra penale trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga paragrafi 1 mund të kryhet: 1) me përdorimin haptas të mjetit apo të metodës së papërshtatshme të mjekimit; 2) me mos përdorim të masave përkatëse higjienike, ndërsa paragrafi 3 merr karakterin rëndues për shkak të pasojave, lëndimi i rëndë trupor. Pra sipas kësaj dispozite vepra penale kryhet kur përdorën haptas mjete apo metoda të pa përshtatshme të mjekimit ose mospërdorimi i masave përkatëse higjienike nga ana e mjekut gjatë aktivitetit të tij dhe me këtë rast shkaktohet keqësim i shëndetit të personit. Pra kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje eventuale dhe për të ekzistuar vepra penale gjithnjë duhet të ekzistoj lidhja shkakësore në mes të veprimit në të cilin kryhet vepra penale dhe shkakimit të pasojës

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, prova të cilat janë bashkangjitur dhe propozuar në aktakuzë nuk e mbështesin dyshimin e bazuar mirë në drejtim të elementeve të veprës penale për të cilën ngarkohet i pandehuri me akuzë. Gjykata vlerëson se aktakuza nuk përmban figurën e kësaj vepre penale pasi që nga vetë përshkrimi faktik i akuzës, por edhe nga provat që janë bashkangjitur akuzës nuk rezulton se i pandehuri gjatë trajtimit mjekësor të të dëmtuarës të ketë përdorë haptas metoda apo mjete të papërshtatshme ose mos ketë përdor masa përkatëse higjienike, si rezultat i të cilave më pas ta ketë keqësuar gjendjen e pacientes-të dëmtuarës, sepse matja e gabuar siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës nuk ka qenë faktor kyç i cili ka ndikuar në shfaqjen dhe avancimin e shkallës së deformitetit të boshtit kurrizor , ndërsa nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se e dëmtuara ka mundësi të ketë lindur me skoliozë dhe se hera e parë që është diagnostifikuar e dëmtuara ka

qenë në moshën nëntë vjeçare ndërsa trajtimi mjekësorë nga i akuzuari Dr. [] ka filluar mbas një viti, ndërsa i njëjti në bazë të raporteve mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës si dhe ekspertizës mjekoligjore të dt:04.06.2014 të dhënë nga Dr. [], [] dhe [] të cilët edhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 22.02.2018 kanë deklaruar se e mbështesin mendimin e dhënë në ekspertizë, me ndryshim se ka qenë gabim teknik konstatimi se është bërë edhe ekzaminimi fizik i të dëmtuarës, rezulton se i akuzuari ka përdorur metoda të lejuara dhe të testuar nga shkenca e mjekisë ndërsa në diapozitiv të aktakuzës nuk është përshkruar asnjëherë saktë se cila metodë është përdorur haptazi nga ana e të akuzuarit e cila është në kundërshtim me të arriturat shkencore dhe po ashtu nuk është përshkruar dhe vërtetuar dashje eventuale si elementi tjetër thelbësor i veprës penale trajtimi i pa ndërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.3 lidhur me par.1 të KPPRK-së, pra përdorimi haptas i metodave dhe dashja eventuale janë elemente thelbësore të veprës penale për çka në rastin konkret mungojnë.

Në dispozitiv të aktakuzës në përshkrimin e veprimeve inkriminuese thuhet se “ka përdorur haptas një metodë të pa përshtatshme të mjekimit, ashtu që nuk e ka paraqitur gjendjen reale të shkallës së deformitetit dhe nuk i ka rekomanduar me kohë mbajtjen apo përdorimin e Ortozës (Korsetit)”, për çka e bënë akuzën të jetë konfuzë dhe në kundërshtim me të gjithash elementet e veprës penale trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor nga 260 par 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, ngase ligjvënësi e ka përdorë shprehjen “*haptas*” me rastin e përshkrimit të kësaj vepre penale çka do të thotë se për të ekzistuar kjo vepër penale duhet të ekzistojë dashja eventuale, pra kryesi duhet të jetë i vetëdijshëm dhe koshient se po përdorë metodë apo mjete të papërshtatshme të mjekimit, pra kërkohet që i pandehuri gjatë mjekimit me metodat apo mjetet e mjekimit të ketë ndikuar në shkaktimin e pasojës, për çka në dispozitivin e akuzë asnjëra nga këto elemente nuk ekzistojnë, dhe fakti se nuk ka bërë matje të saktë sipas vlerësimit të gjykatës nuk përbën vepër penale, pasi që vepra penale do të ekzistonte po që se i pandehuri me veprimet e tij gjatë mjekimit ka ndikuar që të shfaqet pasoja në të dëmtuarën, ndërsa në rastin konkret e dëmtuara një vit pasi është identifikua me skolioz e ka filluar trajtimin te i akuzuari, pra pasoja nuk është paraqitur por veç se ka ekzistuar në kohën kur ka filluar trajtimin mjekësor. Po ashtu siç është theksuar edhe më lartë për të ekzistuar kjo vepër penale duhet të ekzistojë edhe lidhja shkakësore në mes të veprimit në të cilin kryhet vepra penale dhe shkaktimit të pasojës, andaj në rastin konkret kjo lidhje mungon ngase nga të gjitha provat që janë bashkangjitur akuzës, në veçanti Ekspertiza mjeko-ligjore e Departamentit të Mjekësisë Ligjore të dt. 04.06.2014 Konfirmon se trajtimi i pacientes [] nga ana e të akuzuarit është bërë konform standardeve dhe protokolleve trajtuese të cilat aplikohen në botë. Të njëjtin konfirmim e kanë mbështet dhe ripërsëritur edhe hartuesit e kësaj Ekspertize, Dr. [] dhe Dr. [] në shqyrtimin e dt. 22.02.2018. Nga Raportet

mjekësore të lëshuar nga i akuzuari në periudhën prej 01.02.2011 deri më 20.09.2013 vërtetohet se të njëjtat përmbanin udhëzimet konform standardeve dhe protokolleve trajtuese të deformitetit të boshtit kurrizor të të dëmtuarës të cilat aplikohen në botë, përfshi terapinë fizikale, notin si dhe udhëzimin për vendosjen e Ortozës TLSO, ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit Dr. [redacted] dëgjuar në shqyrtimin e dt. 08.12.2017 dhe Dr. [redacted] i dëgjuar në shqyrtimin e dt. 25.01.2018, është vërtetuar se i akuzuari nuk ka përdorur ndonjë metodë e cila nuk është vërtetuar shkencërisht, ndërsa të njëjtit kanë dëshmuar se lidhur me trajtimin e skoliozës, ekzistojnë disa shkolla dhe metoda të trajtimit të kësaj sëmundjeje si ajo e Lionit, shkolla Amerikane, kanë sqaruar se e dëmtuara ka pas skoliozë ideopatique që do të thotë se shkaktaret e kësaj sëmundjeje janë të pa njohur, për çka edhe trajtimi i sajë duhet të behet me metoda të cilat janë të njohura por që nuk do të thotë se në mjekësi përdorimi i metodave mjekësore çdo herë mund të ketë efekte pozitive, ndërsa dr. [redacted] ka dëshmuar se Ortoza duhet të vendoset prej 20 deri ne 50 shkallë, dëshmitari ka sqaruar duke përdorur shprehjen “se këtu kemi të bëjmë me mjekësi e jo me matematik “ çka do të thotë se një dhe një nuk bëjnë dy, prandaj edhe përcaktimi prej 20 deri ne 50 shkallë është relativ dhe nuk është strikt, sepse janë edhe shume faktor tjerë të cilët duhet të analizohen për të marrë një vendim të plotë për trajtim, duke shtuar se sa i përket trajtimit të kësaj sëmundjeje ka disa shkolla që i japin prioritet terapive fizikale ndërsa disa të tjera ju japin ortozave, ndera kombinimi i të dyjave konsideron se do të jepte rezultate më të mira. Gjykata sikurse provave të vlerësuara me lart ashtu edhe ekspertizës së hartuar nga mjeku Gjerman Dr. [redacted] të dt. 07 Korrik 2016 i ka kushtuar kujdes të veçante si provë e veçantë por edhe në lidhmëni me provat tjera të cilat janë proceduar gjatë shqyrtimeve gjyqësore në këtë çështje penale të vlerësuara më lart, ashtu që gjykata vlerëson dhe konstaton se në 11(Njëmbëdhjetë) pyetjet e parashtruara nga prokuroria në të cilat eksperti ndërkombëtar dr. [redacted] është përgjigjur duke krijuar një konfuzitet nga njëra në tjetrën ashtu që në përgjigjen e parë jep mendim se gjatë progresionit të këndit shtrembëruar duhet të filloj tretmani me korset, ndërsa në përgjigjejen e dytë thekson se duhet të merren parasysh me rastin e vendosjes edhe gjinia, pjekuria seksuale, si dhe fillimi i cilit menstrual, në përgjigjen me nr 9 ka shtuar se korseti Millwoki në gjermani nuk përdoret, ndërsa në rastin e tillë do të rekomandohet një terapi operative, dhe në përgjigjejen e 10 ka shtuar se nuk është e mundur që një skolioz të përmirësohet me korset, por në bazë të rregullave është e mundur vetëm të ndalohet progresi i zhvillimit të skoliozës duke shtuar se është mahnitëse dhe për tu vlerësuar për të mirë që në këtë rast, pas përshkrimit dhe mbajtjen e korsetit është arrit një tërheqje e shtrembërimit të Boshtit kurrizor, e që në përgjigjejen me nr.11 ka sqaruar rezultatet e arritura në përmirësimin e boshtit pas përdorimit të korsetit ashtu që nga 52 shkallë përmirësimi i shtrembërimit ka arritur në 27

shkallë, duke e cilësuar si rezultat të mahnitshëm optimal të përmirësimit për çka edhe nuk ka nevojë tani për një terapi operative, ashtu që për gjykatën mbetet e pa qartë se përderisa në përgjigjëjen e parë deklararon se duhet të filloj tretmani me Korset, ndërsa në përgjigjeje, me nr. 9 deklararon se Korseti Millwoki në gjermani nuk përdoret për gjykatën këto dy përgjegjëje janë në kundërshtim me njëra tjetrën, po ashtu në përgjigjen 11 ka sqaruar se është arrit rezultat i mahnitshëm optimal me përdorimin e korsetit Millwoki ndërsa në pyetjen e 10 ka theksuar se nuk është e mundur që me korset një skolioz të përmirësohet por vetëm të ndalohe progresioni i shtrembërimit, atëher si është e mundur që në rastin konkret të arrihet një përmirësim kaq mahnitës me një mjet që nuk shërben për shërim por për parandalim të progresionit, andaj këto janë disa nga arsyet që i japin konfuzitet mendimit të ekspertit Dr. [REDACTED] të dt. 07 Korrik 2016, megjithatë në asnjërën nga përgjigjejet në ekspertizë nuk ka sqaruar se cila ka qenë ajo metodë e ndaluar e cila nuk është vërtetuar në aspektin e shkencës së mjekësisë e që i akuzuari e ka aplikuar me rastin e trajtimit të [REDACTED] e që si rrjedhojë e sajë ajo ka pësuar dëmtime të rënda trupore, po ashtu nuk ka sqaruar se nga cilat veprime apo metoda të ndaluara janë shkaktuar dëmtimet e rënda trupore ashtu siç pretendon prokuroria e që do të sqaronte lidhjen kauzale mes veprimit dhe pasojës së shkaktuar.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe dëshminë e përfaqësuesit ligjor të të dëmtuarës- Babait [REDACTED] [REDACTED] i cili në detaje ka dëshmuar faktin se vajza e tij [REDACTED] është trajtuar nga i akuzuari në periudhën 2011 e deri me 20.09.2013 si dhe ka dëshmuar se i janë përmbajtur rekomandimeve dhe këshillave të dhënë si në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës, por me gjithë atë vajza e tij nuk është përmirësuar por përkundrazi shkalla e deformitetit vetëm se ka shënuar progresion, duke shtuar se konsideroj se si mjek –Ortopedi është dashur ta di të bëjë matje, të na njoftoi lidhur me shkallen e deformitetit dhe po ashtu të marrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të shërimit të vajzës [REDACTED] ndërsa ka shtuar se raportet si të tij ashtu edhe të bashkëshortes dhe të vajzës më tani të akuzuarin gjatë trajtimit mjekësor kanë qenë normale, por që trajtimi nuk është bërë i duhuri dhe konsideron se i akuzuari ka dashtë që të dëmtuarës ti shkaktoj dëmtim trupor duke mos e treguar nivelin e shkallës së defomitetit të boshtit kurrizor për të dëmtuarën, gjykata i konsideron si t drejta këto shqetësime nga ana e prindërve por nga dëshmia e tij përveç fakti jo kontestues se [REDACTED] është trajtuar në periudhën e lartcekur, fakt ky i cili gjen mbështetje edhe në provat tjera në shkresat e lëndës, nuk mund të provohet se cila ka qenë ajo metodë apo mjet haptaz i përdorur dhe cila është arsyeja e cila e ka shtyrë tani të akuzuarin që të marrë një veprim me dashje që ti shkaktoj dëmtim të rëndë shëndetit vajzës së tij, nga dëshmia e tij si dhe nga provat materiale , konkretisht raportet mjekësore është vërtetuar se në këtë periudhë [REDACTED] i janë rekomanduar terapi fizikale dhe not, ndërsa në raportin e fundit të njëjtës i është

rekomanduar vendosja e korsetit "TLSO", por me që shkalla e deformitetit të boshtit Kurrizor nga njoftimi i fundit prej 52 shkallë ka shkaktuar shqetësim të madh te prindërit për çka edhe të njëjtit e kanë vazhduar tretmanin mjekësor në Ordinancën [redacted], nga dr, [redacted] i cili menjëherë po ashtu sikurse edhe i akuzuari i ka rekomanduar vendosjen e kosetit të quajtur Millwoki, por që është vërtetuar si nga Dr [redacted] ashtu edhe dr. [redacted] si dhe edhe i akuzuari këto dy mjete si Ortoza TLSO edhe ajo Millwoki kanë të njëjtin qëllim ndalimin e progresionit të deformitetit të shtyllës kurrizore, me dallim se Millwoki si shtesë ka edhe pjesën e qafës. Nga kjo dëshmi nuk është vërtetuar se i akuzuari ka përdor ndonjë metodë e cila është në kundërshtim me shkencën e mjekësisë si dhe dashjen si element i veprës penale për të cilën i pandehuri është akuzuar por përkundrazi metodat e përdorura janë të lejuara në shkencën e mjekësisë.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit të dhëne në shqyrtimin gjyqësor i cili deklaroi se me profesion është Mjek i specializuar [redacted] dhe se merret me trajtimin e skoliozave ndërsa nuk e mohon faktin se e ka trajtuar [redacted] nga viti 2011 e deri 20.09.2013 duke i kushtuar kujdes të veçantë në trajtimin mjekësor ashtu që i ka rekomanduar terapi fizike si dhe not por arsyeja pse nuk e ka rekomanduar menjëherë vendosjen e korsetit, është fakti se ka vlerësuar se duke pas parasysh faktorët si moshën, gjinia si dhe parametrat tjerë të rëndësishëm që ndërlidhen me karakteristikat e veçanta të secilit pacient si dhe pasojat e mundshme të cilat mund të shkaktoj edhe vetë vendosja e korsetit, duke shtuar se korseti ka si qëllim vetëm parandalimin e progresionit por jo edhe shërimin e skoliozës, dhe se lidhur me metodat për të cilat i ka aplikuar në rastin konkret Kosova nuk ka protokolle shtetërore por është bazuar në shkollën amerikane si dhe disa organizatave ndërkombëtare të cilat japin rekomandime lidhur me metodat të cilat duhen të përdoren, e sa i përket gabimeve në matje të shkallës së deformitetit ka sqaruar se ekzistojnë disa metoda dhe ai ka përdor metodën kompjuterike në të cilën edhe është bazuar, por ka theksuar se nuk ka ndonjë limit strikt se kur duhet vendoset Ortoza –korseti por krejt kjo varet nga karakteristikat e veçanta të pacientit të përmendura më lartë, e ka mohuar faktin se ka dashur ose ka pasur për qëllim që [redacted] ti shkaktoj dëmtim të rënd të shëndetit duke e konsideruar si diçka jo normale për dike, ndërsa ka shtuar se [redacted] e ka trajtuar me kujdes dhe simpati të veçantë pasi që e njëjta edhe ka qenë e moshës së vajzës së tij, kësaj mbrojtje nga ana e të akuzuarit gjykata ia falë besimin pasi që ka rrjedh logjike si dhe gjënë mbështetje edhe në provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqësor si ato personale edhe materiale.

Gjykata i ka vlerësuar edhe dëshmitë e dëshmitarëve tjerë të propozuar nga Prokuroria si Dëshmitari [redacted], nga këto dëshmi nuk mund të konstatohet apo të

vërtetohet ndonjë veprim i cili është ndërmarrë nga ana e të akuzuarit në drejtim të veprës penale për të cilën akuzohet, dhe gjykata i konsideron si prova të cilat nuk kanë dhënë kontribut të veçantë në ndriçimin e gjendjes faktike përveç përshtypjes pozitive për të akuzuarin, ndërsa Mendimi i Komisionit të QKUK-së Klinika e Ortopedisë i dt. 03.10.2014, hartuesit e këtij mendimi kanë deklaruar se lidhur me këtë çështje nuk mund të japin mendim.

Pra nga të gjitha këto gjykata konstaton se nuk ka prova për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë dhe përtej këtij dyshimi se i pandehuri në cilësinë e mjekut të ketë kryer veprën penale për të cilën ngarkohet me akuzë dhe jo çdo dyshim është i mjaftueshëm për të ngritur aktakuzë nga ana e Prokurorit të Shtetit apo edhe për ta shpallur fajtor të akuzuarin, por duhet të ekzistoi një shkallë tejet e lartë e dyshimit, përkatësisht duhet të ekzistojë dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Një gjë e tillë është parashikuar në disa dispozita ligjore por vlen të përmendet neni 240 i KPP-së. Në nenin 240 par.1 të KPP-së është parashikuar se “për tu ngritur aktakuzë duhet të ekzistojë një dyshim i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale”. Pra për-tu ngritur aktakuza duhet që të ekzistojë “dyshimi i bazuar mirë” dhe është detyrim i Prokurorit të Shtetit, që gjykatës t’ia argumentoi se ekziston një dyshim i tillë gjë që në këtë çështje penale nuk është vepruar në këtë mënyrë pasi që të gjitha provat si ato të propozuara nga prokuroria si dhe ato nga mbrojtja e të cilat secila veç e veç si në lidhmëni me njëra tjetrën dëshmojnë pafajësinë e të pandehurit lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet nga prokuroria.

Po ashtu, gjykata në bindjet e sajë vlerëson se i pandehuri nuk ka pasur asnjë leverdi apo interes nga kryerja e kësaj vepre penale, pasi që i njëjti është mjekë me profesion, ka ndërtuar një karrierë profesionale, punon nën betim, dhe se kryerja e një vepre penale do të ndikonte direkt në karrierën e tij si dhe në imazhin e tij të krijuar me punën e mirë për çka është dëshmuar edhe nga dëshmitarët e dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor të cilët kanë theksuar se për doktorin kanë dëgjuar nga familjarët e tyre dhe se kanë vetëm fjalë të mira.

Nga foto dhe dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë deformimet i shtyllës kurrizore i të dëmtuarës por në aspektin subjektiv nuk mund të lidhen me veprimin e të akuzuarit pasi që skolioza si sëmundje nuk është shkaktuar nga i akuzuari por së vetëm është trajtuar pasi që është konstatuar se e dëmtuara vuan nga kjo sëmundje, trajtimi i sajë ka filluar një vite më vonë pas identifikimit të skoliozës, për çka edhe nuk mund ti kontribuohet shkaktimi i pasojës në rastin konkret të akuzuarit sepse pasoja në momentin e fillimit të trajtimit veç se ka ekzistuar.

Andaj nga të gjitha provat e lartpërmendura konstatohet se nuk ekziston lidhja kauzale mes veprimit dhe pasojës së shkaktuar si dhe dashja si elemente qenësore të veprës penale trajtimi i pa ndërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par3 lidhur me par.1 të KPRK-së

Vendimi për ta liruar të pandehurin nga Akuza

Lidhur me pretendimet e Prokurorit të shtetit, se i pandehuri ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata pas administrimit të provave, ka vlerësuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer këtë veprë penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e ka liruar nga akuza.

Sipas nenit 3 par.2 të KPPRK-së, e duke pas parasysh parimin **In dubio pro reo**, ku thuhet se: Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij, andaj me qenë se në rastin konkret të gjitha provat e administruara e dëshmojnë pafajësinë e të pandehurit me përjashtim të ekspertizës së mjekut Gjerman e dt. 07 Korrik 2016 e cila për gjykatën ka pasur disa mëdyshje dhe e ngelur si provë e vetme dhe në kundërshtim me vetveten si dhe mbi bazën e të thënave më lart gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 3, të KPPK, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 454, par. 1 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i përgjithshëm-Penal

P.nr.4193/16, të dt:16.03.2018

Zyrtare Ligjore,

Dafina Ymeri



Gjyqtari,

Kujtim Krasniqi



UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë

